



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 485/1 Prot.

Tiranë, më 06.04.2023

V E N D I M

Nr. 50, Datë 06.04.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 146, datë 21.09.2022, të paraqitur nga A.B kundër Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*gjendjes arsimore*” dhe “*çdo shkak tjetër*¹”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se: “*Pas shpalljes së thirrjes së Programit Kombëtar të Praktikave, organizuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, kam aplikuar nëpërmjet plotësimit të të dhënave në faqen e internetit të Programit duke dërguar CV-në dhe një letër motivimi. Në opsionin që lidhej me arsimin kam zgjedhur “tjetër”, pasi sapo kam përfunduar vitin e tretë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në Programin e Integruar 5-vjeçar. Me anë të e-mailit jam njoftuar nga Ministria e Drejtësisë se isha përzgjedhur, dhe për të vijuar më tej me aplikimin, duhet të dërgoja një letër reference, listë notash, dhe diplomën. Diplomën nuk e disponoja pasi në ndryshim nga studentët e programit të Bolonjës që pas tre viteve studime merrnin një diplomë, ne studentët e Programit të Integruar duhet të presim përfundimin e studimeve për ta marrë një të tillë e për të filluar një*

¹ Përkatësisë në brezin e studentëve të drejtësisë, që në vitin 2019, filluan studimet në Programin e Integruar 5-vjeçar.

praktikë në administratën shtetërore, duke u vendosur kështu në kushte më pak të favorshme në raport me studentët e tjerë të drejtësisë që janë rregjistruar për studime para vitit 2019, vit kur hynë në fuqi ndryshimet ligjore. Kushtëzimi me zotërimin e diplomës për fillimin e një praktike profesionale në administratë ndaj meje si student që sapo e kisha kryer vitin e tretë dhe që në raport me studentët të programit të vjetër atë të Bolonjës, 3+2, zotëroj për afërsisht të njëjtat dije dhe njohuri, është një qëndrim joproporcional dhe dukshëm diskriminues pasi nuk është në përputhje edhe me qëllimin e vet programit, që ka të bëjë me aftësimin praktik të studentëve. Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka një trajtim diskriminues pasi vendos si kriter kryerjen e studimeve dhe të pasurit minimalisht një diplomë Bachelor për të konkuruar, duke shpërfillur ata që kanë kryer 3 vite studime në një program të integruar, që është analogu i një Bachelori.

Kam zgjedhur “çdo shkak tjetër”, për shkak se kam filluar studimet në vitin 2019 dhe jam pjesë e një grupi të rinjsh të cilët nuk mund të aksesojnë programet kombëtare për praktika në administratën shtetërore, më përpara se të diplomohen, pra pas 5 viteve studime, kohë në të cilën duhet të jenë të punësuar, e jo në praktika profesionale të papaguara”.

Në përfundim, subjekti ankues kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit lidhur me kushtet dhe kriteret e dy ministrive dhe marrjen e masave nëpërmjet rekomandimeve ndaj Ministrisë së Drejtësisë lidhur me qëndrimin që duhet të mbajë ndaj studentëve që aplikojnë për praktika dhe kanë mbaruar minimalisht vitin e tretë të studimeve. Ankuesi kërkon dhe marrjen e masave nëpërmjet rekomandimeve ndaj Ministrisë për Rininë dhe Fëmijët që të ndryshojë kriterin e Bachelorit për ta bërë të përshtatshëm programin edhe për studentët e Programit të Integruar që kanë përfunduar vitin e tretë të studimeve.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1277/1, datë 29.09.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga institucionet, për ankesën e bërë nga A.B si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Shpjegime lidhur me diferencimin që bën Programi Kombëtar i Praktikave të Punës aplikantëve që zotërojnë diplomën “Bachelor” dhe aplikantëve që kanë mbaruar vitin e III-të të studimeve në programet e integruara 5-vjeçare.
 - Kopje të korrespondencës që Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministria e Drejtësisë kanë pasur me ankuesin, lidhur me problematikën, objekt i ankesës.

- Informacion nëse gjatë vitit të kaluar dhe këtij viti ka pasur ankesa nga aplikues të tjerë të skualifikuar për arsyen objekt i ankesës dhe si janë zgjidhur ato.
- Kopje të metodologjisë së Programit Kombëtar të Praktikave të Punës.
- Informacion lidhur me kriteret dhe profilin e praktikantëve të kërkuar nga programi i praktikave të punës nga ana e Ministrisë së Drejtësisë.

Me shkresën nr. 5200/1, datë 13.10.2022, Ministria e Drejtësisë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, sipas përcaktimeve të VKM nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar, organizohet nga ministria përgjegjëse për rininë, e cila mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. Në pikën 6, të këtij akti nënligjor përcaktohet gjithashtu se: “Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri përgjegjës për rininë, që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit”. Ministria e Drejtësisë, në zbatim të pikës 7, të VKM nr. 395, datë 29.04.2015, të ndryshuar, si dhe në vijim të shkresës me nr. 3200, datë 02.06.2022, të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ka përcjellë pranë kësaj të fundit numrin e praktikantëve të kërkuar për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, dhe institucionet e saj të varësisë, duke specifikuar dhe profilet përkatëse studimore të kërkuara. Përkatësisht numri i praktikantëve të kërkuar për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, ka qenë 15 praktikantë, me profilet studimore si vijon: 9 profili juridik; 2 profili histori-filologji; 4 profili ekonomik.*

Në pikën 2, të Urdhrit nr. 2, datë 27.05.2022, “Për shpalljen e “Thirrjes së shtatë” në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës”, të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përcaktohet se: “Programi Kombëtar i Praktikave të Punës për vitin 2022, do të realizohet sipas planit të veprimit dhe metodologjisë bashkëlidhur këtij urdhri”.

Gjithashtu, në pikën 3 “Kriteret e aplikimit”, të Metodologjisë së miratuar, përcaktohet ndër të tjera se: “b. Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datë 12.09.2022”. Ky kriter lidhur me diplomimin, është i përcaktuar gjithashtu dhe në VKM nr. 395, datë 29.04.2015, i ndryshuar, ku në pikën 3 të saj, parashikohet se: “Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor””.

Gjithashtu, në Metodologjinë e miratuar, konkretisht në pikën 10 të saj “Përzgjedhja e kandidatëve fitues”, përcaktohet mënyra e vlerësimit të aplikimeve të paraqitura, referuar dokumentacionit të dërguar, dhe konkretisht:

- Vlerësimi për nivelin e diplomës:
 - a) Bachelor 5 pikë;
 - b) Master Profesional 10 pikë;
 - c) Master shkencor 15 pikë.

- Vlerësimi për mesataren e notave:
 - a) 5-6 5 pikë
 - b) 7-8 10 pikë
 - c) 9-10 15 pikë
- Letra e motivimit vlerësohet nga 1 deri në 10 pikë.

Në përfundim të afatit të aplikimit të përcaktuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, janë përcjellë pranë Ministrisë së Drejtësisë, në mënyrë elektronike, listat e kandidatëve që kanë shprehur interes për zhvillimin e praktikës pranë aparatit të Ministrisë së Drejtësisë, sipas vendeve vakante të përcaktuara nga ky institucion, aplikime të cilat janë marrë në shqyrtim nga komisioni përgjegjës, i ngritur me Urdhrin nr. 268, datë 13.06.2022 “Për ngritjen e Komisionit të përzgjedhjes së praktikantëve në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Thirrja VII”.

Lidhur me aplikimin e paraqitur nga ana e A.B, i cili është përcjellë në rrugë elektronike pranë Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se me datë 25.08.2022, nga ana e komisionit është proceduar me paraqitjen e kërkesës për dërgimin e dokumentacionit të nevojshëm nga ana e subjektit aplikues, me qëllim vijimin e vlerësimit për përmbushjen e kriterëve të aplikimit për zhvillimin e praktikës pranë institucionit tonë.

Nga dokumentacioni i administruar, nga A.B rezulton se nuk është përcjellë diploma e përfundimit të studimeve, pasi nga lista e notave të përcjellë, rezulton se aktualisht është në vijim të studimeve në Drejtësi, në Programin e Integruar të Sistemit 5-vjeçar.

Në kushtet kur, sipas pikës 3, të VKM nr. 395, datë 29.04.2015, i ndryshuar dhe Metodologjisë dhe Planit të veprimit, të miratuar nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, përcaktohet si një nga kriteret e aplikimit që: “Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datë 12 Shtator 2022”, nga ana e Komisionit të vlerësimit, është proceduar me moskualifikimin e A.B, për shkak se nga dokumentacioni i përcjellë nuk rezulton të disponojë diplomë të përfundimit të studimeve, pasi rezulton të jetë ende në proces studimi.

Gjithashtu, referuar dhe ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 22, të nenit 6, përcaktohet se: “Programi i studimit” është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit. Si dhe në pikën 3, të nenit 73, të këtij ligji parashikohet se: “Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimit të kryer”.

Gjithashtu, në nenin 82, pika 1, të ligjit 80/2015, përcaktohet se: “1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike”.

Përsa më sipër, rezulton se subjekti aplikues, nuk plotëson një nga kriteret e aplikimit, që ka të bëjë me përfundimin e një programi studimi, për të cilën pajiset në përfundim me një akt përkatës që vërteton përfundimin me sukses të studimeve, që është diploma universitare. Gjithashtu lidhur me sa kërkohet nga ana juaj, nga informacioni i komunikuar nuk rezulton që pranë Ministrisë së Drejtësisë të jenë paraqitur ankesa me këtë objekt, nga ana e subjekteve aplikuese”.

Në kundërshtim të shkresës së Ministrisë së Drejtësisë, subjekti ankues me e-mail-in datë 17.10.2022, në mes të tjerash ka parashtruar se: *“Vendimmarrja e Ministrisë së Drejtësisë është në bazë e për zbatim të kriterëve ligjore dhe Metodologjisë dhe Planit të Veprimit të Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët. Është e vërtetë se kriteret ligjore nuk lejojnë kualifikimin e kandidatëve që nuk kanë mbyllur ciklin e studimeve në një program studimi, por është lënë e pa sqaruar situata kur studenti ndjek një program të integruar, program i cili më parë ishte i një natyre të tillë që lejonte kualifikimin në Programin Kombëtar të Praktikave. Vlerësimin e situatës dhe nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse duhet t’i kishte kryer Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në mënyrë që të garantohej drejtësia në përzgjedhje dhe gjithëpërfshirja në një program me shumë rëndësi në formimin profesional. VKM nr. 395, datë 29.04.2015, nuk është relevant në rastin konkret pasi zbatimi i Programit të Integruar ka filluar në vitin 2019, vit kur u miratuan edhe ndryshimet ligjore në bazë të së cilave ndryshoi struktura akademike e studimeve për Drejtësi. Në kushtet e ometimit ligjor, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në cilësinë e institucionit që garanton mbarëvajtjen e Programit Kombëtar të Praktikave, duhet që të kishte marrë masat e nevojshme që do të lejonin që edhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë që sapo përfundojnë vitin e tretë apo të katërt, megjithëse nuk kanë një diplomë, të mund të kualifikohen”.*

- Me shkresën nr. 1277/3, datë 21.10.2022, “Kujtesë”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar përsëri informacionin nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët.

Me shkresën nr. 5412/2, datë 24.10.2022, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Programi Kombëtar i Praktikave të Punës zbatohet në përputhje me VKM nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar, dhe synon ti sigurojë profesionistëve të rinj një eksperiencë pune të integruar dhe në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me sistemin administrativ publik, në nivel qendror dhe vendor. Në pikën 3 të vendimit është parashikuar se: “Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”. Në bazë dhe për zbatim të këtij vendimi, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka miratuar Urdhrin nr. 2, datë 27.05.2022 “Për shpalljen e thirrjes së shtatë në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës”, i cili përcakton metodologjinë e organizmit, afatet dhe procedurat e aplikimit, dokumentacionin, kriteret e përzgjedhjes dhe angazhimin të*

kandidatëve nga institucionet e administratës shtetërore dhe certifikimit të tyre në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës për vitin 2022. Sipas parashikimeve të Urdhrit, në shkronjën b), pika 3 “Kriteret e aplikimit”: “Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datë 12.09.2022”.

Sa më lart, dëshirojmë të theksojmë se kushti i pajisjes me diplomën e ciklit “Bachelor” për aplikantët në program, duke qenë i parashikuar në VKM nr. 395, datë 29.04.2015, është detyrues për Ministrinë e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në përgatitjen e metodologjisë për thirrjen vjetore të programit kombëtar të praktikave të punës dhe për Ministrinë e Drejtësisë, apo çdo institucion tjetër pritës të administratës shtetërore, për përzgjedhjen dhe angazhimin e aplikantëve pranë institucionit të tyre. Në këtë kuadër theksojmë, se ky kusht nuk synon ti vendosë aplikantët në kushte të pabarabarta dhe nuk është vendosur në Thirrjen e VII-të, por ka qenë kriter për aplikantët në gjashtë thirrjet paraardhëse për programin kombëtar të praktikave të punës.

Në terma statistikore, në kuadër të këtyre aplikimeve gjatë këtij viti (1 Korrik-10 Gusht 2022) kanë shprehur interesin e tyre në platformën <http://rinia.gov.al>, 1096 aplikantë dhe janë përzgjedhur 450 fitues, të cilët pasi të përfundojnë me sukses periudhën e praktikës do të pajisen me certifikatë të lëshuar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Departamenti i Administratës Publike dhe një pjesë e madhe prej tyre do ti ofrohet mundësia për t’u punësuar pranë institucioneve pritëse.

Gjithashtu, do të donim të nënvizojmë se programi i integruar 3+2, i pashkëputur për studentet e Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, është vendosur vetëm në vitet e fundit nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, nëpërmjet Udhëzimit nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në Institucionet e Arsimit të Lartë” dhe është hera e parë që brezi i studentëve që kanë filluar studimet e integruara pesëvjeçare në vitin 2019 dhe që do të duhej të mbaronin ciklin Bachelor në vitin 2022 (sipas sistemit të mëparshëm), kanë paraqitur këtë pretendim në institucionin tonë. Megjithatë, duhet theksuar se studentët e Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit të Tiranës, nuk janë të përjashtuar nga mundësia e përfshirjes në programin kombëtar të praktikave të punës, por do mund të përfshihen në thirrjen vjetore pas diplomimit të tyre. Pretendimi i ankuesit që programi e humb vlerën për studentët me diplomë “Master”, në këndvështrimin tonë nuk qëndron, pasi niveli i angazhimit në institucionin pritës dhe detyrat e caktuara praktikantit nga institucioni shtetëror lidhen drejtpërdrejtë me nivelin e dijeve dhe aftësive individuale. Në këtë aspekt, një kandidat i specializuar do të kishte mundësi të shtuara për të marrë përsipër detyra më komplekse dhe vijuar angazhimin në institucionin pritës pas përfundimit të praktikës së punës”.

Në kundërshtim të shkresës së Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, subjekti ankues me e-mail-in datë 29.10.2022, në mes të tjerash ka parashtruar se: “Parashtrimet e Ministrisë janë të sakta dhe qëndrojnë, por duket qartë që boshllëqet ligjore lidhur me studentët e drejtësisë për studimet e të cilëve ka pasur ndryshime thelbësore, janë neglizhuar dhe nuk është marrë asnjë

vendim nga Këshilli i Ministrave apo të jetë nxjerrë ndonjë udhëzim nga Ministria që do të garantonte edhe përfshirjen e studentëve të Programit të Integruar që kanë mbaruar minimalisht vitin e tretë”.

- Me shkresën nr. 1277/5, datë 31.10.2022, Komisioneri, ka kërkuar informacion shtesë, lidhur me pretendimin e ankuesit se: *“Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve ka të përfshirë praktikantë me të njëjtin arsim si ai, por ndërkohë që ai u skualifikua nga Ministria e Drejtësisë në institucionet e varësisë të kësaj Ministrie janë pranuar praktikantë pa diplomë”.*

Me shkresën nr. 5200/3, datë 04.11.2022, Ministria e Drejtësisë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve jemi informuar se nuk ka asnjë aplikant të shpallur fitues që është student në Programin e Integruar 5-vjeçar, ku sqaron se të gjithë praktikantët kanë mbaruar minimalisht nivelin e studimeve të ciklit të parë ‘Bachelor’”.*

Me shkresën nr. 5412/4, datë 11.11.2022, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“VKM nr. 395, datë 29.04.2015 “Për Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në Administratën Shtetërore dhe Institucionet e tjera Publike”, i ndryshuar, në pikën 3 të tij ka parashikuar shprehimisht se: “Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, përcakton hierarkinë e legjislacionit dhe Vendimi i Këshillit të Ministrave si akt normativ me efekt të përgjithshëm është detyrues për institucionet e administratës shtetërore. Rrjedhimisht, pretendimi i ankuesit që Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët mund të kishte nxjerrë ndonjë udhëzim që të përfshinte në program studentët të pa pajisur me diplomë nuk është i bazuar, pasi një rregullim i tillë do të binte ndesh me rregullimin e një akti juridik më të lartë siç është Vendimi i Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, ritheksojmë se një element i rëndësishëm i lidhur me pjesëmarrjen e të diplomuarve në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, lidhet me punësimin nga institucioni pritës pas përfundimit të praktikës në program. Ndërsa ky element nuk është përcaktuar si detyrues në VKM 395/2015, të ndryshuar, mbetet një element mjaft i rëndësishëm nga pikëpamja faktike, ku çdo vit mesatarisht, një në tre të diplomuar që përfshihen në program, ju ofrohet një kontratë 1-vjeçare pune nga institucionet pritëse, pas përfundimit të programit. Në këtë aspekt, vlen të mbahet në konsideratë, që mospasja e diplomës për një kandidat pjesëmarrës në program, do të pamundësonte angazhimin e punës në një institucion shtetëror, pavarësisht nga vlerësimi i cilësive të tij dhe rezultateve të arritura në program”.*

Në kundërshtim të shkresës së Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, subjekti ankues me e-mail-in datë 16.11.2022, në mes të tjerash ka parashtruar se: *“Një program praktikash përveç krijimit të mundësive të të rinjve për t’u punësuar, është edhe një mundësi që ata të njohin aspekte të ndryshme të punës në administratë e në përfundim të mund të bëjnë një vlerësim nëse duan ta*

zhvillojnë karrierën në këtë sektor. Nuk mund të kushtëzohet mospranimi në program vetëm me arsyetimin që ndoshta në fund të tij mund të ketë një ofertë për punësim dhe diploma mund të bëhet pengesë. Vetë eksperiencia në këtë sektor është mëse e mjaftueshme dhe një arritje më vete për një student që për më pak se dy vite do të jetë duke kërkuar një punë si jurist”.

- Me shkresën nr. 1277/8, datë 21.11.2022, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka kërkuar informacion nga Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, si dhe ka kërkuar aktet e poshtë cituara:
 - Informacion lidhur me rregullat e frekuentimit të procesit mësimor, nga studentët e vitit të IV dhe V, të Programit të Integruar 5-vjeçar.
 - Kopje të rregullores së frekuentimit të programit mësimor të Fakultetit Juridik.

Me shkresën nr. 960/1, datë 01.12.2022, Fakulteti i Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Neni 14 i Rregullores së Programit të Studimit të Integruar të Ciklit të Dytë në Drejtësi, të Fakultetit të Drejtësisë të Universitetit të Tiranës parashikon që frekuentimi i leksioneve nuk është i detyrueshëm. Frekuentimi i seminareve, ushtrimeve është i detyrueshëm në të paktën 75% të tyre. Studenti që frekuenton më pak se 75% të seminareve të një lënde humbet të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës në sezonin e rregullt. Ai mund të paraqitet në sezonin e vjeshtës. Studenti që frekuenton më pak se 50% të seminareve të një lënde, humbet të drejtën për të hyrë në provimin e asaj lënde, duke u shpallur përsëritës në atë lëndë. Në këtë rast ai duhet të frekuentojë lëndën në vitin pasardhës, sipas rregullave të sipërpërmendura, që të mund të kualifikohet për të hyrë në provim. Projektet e kursit, të parashikuara në programet mësimore, janë të detyrueshme të shlyhen në masën 100%, në të kundërt, studenti nuk hyn në provimin e lëndës, deri sa t'i shlyejë ato”.*

Me shkresën nr. 6475, datë 12.12.2022, Ministria e Drejtësisë, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Programi Kombëtar i Praktikave të Punës, sipas përcaktimeve të VKM nr. 395, datë 29.04.2015, i ndryshuar, organizohet nga ministria përgjegjëse për rininë, e cila mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. Në këto kushte, Ministria e Drejtësisë, rezulton në cilësinë e një prej institucioneve të administratës shtetërore që mbështetin zhvillimin e këtij programi, i cili sipas përcaktimeve në pikën 6, të aktit nënligjor të sipërcituar, realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri përgjegjës për rininë, që përcakton shpalljen për thirrjet e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit. Ndërsa, lidhur me ndryshimin e VKM-së objekt shqyrtimi, vlerësojmë se është institucioni propozues, i cili ka të drejtën për ndërrmarrjen e nismës për ndryshimin e këtij akti, kur vëren se një ndryshim i tillë është i drejtë, i nevojshëm dhe i bazuar në ligj”.*

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1277/10, datë 05.12.2022 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 15.12.2022, për

të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces, si dhe kërkoi kopje e dokumentacionit, si më poshtë:

- Informacion lidhur me rregullat e frekuentimit të praktikave të punës.
- Kopje të marrëveshjes tip që lidhet mes institucionit ku kryhet praktika dhe praktikantit.

Seanca dëgjimore u zhvillua me praninë e palëve në proces: ankuesi A.B dhe palës kundër së cilës është paraqitur ankesa, përfaqësuesit të Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët z. O.P, përfaqësueses së Ministrisë së Drejtësisë znj. N.P, ndërsa Këshilli i Ministrave, nuk u paraqitën në seancë.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullore të Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Gjatë seancës dëgjimore, subjekti ankues i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe me e-mail me KMD-në, të cilat do të shtjellohen në vijim.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe deklaroi² se: *“Ministria nuk mund të bëjë ndryshimin e VKM-së 395/2015, dhe të hartojë urdhrin për metodologjinë duke ndryshuar kriteret e vendosura nga VKM-ja. Nëse ministria apo institucioneve të tjera nuk do kishin zbatuar kriteret e VKM-së, do ishin në shkelje të ligjit. Me miratimin e VKM-së në vitin 2015, hartimi i urdhrin për zbatimin e kësaj VKM-je, vetëm vitin e fundit ka kaluar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit tek Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, pra ky është viti i parë që administrohet nga ministria e shtetit ky program. Ne si institucion, nuk mund të certifikojmë njohuritë e studentëve në përfundim të vitit të tretë apo të bëjmë analogji të një diplome bachelor me përfundimin e vitit të tretë të studimeve. Ne si ministri për të rritur mundësitë e të rinjve për të pasur sa më shumë mundësi për praktika pune, kemi kontaktuar me shoqëri tregtare dhe OJF, për ti kërkuar që të shtoheshin në program, për sa kohë që ministria kishte infrastrukturën e ngritur, dhe një pjesë e organizatave dhanë dakordësinë e tyre duke ofruar dhe mundësi ekstra, si pagesa për praktikantët, por këto subjekte nuk kanë detyrime për të ndjekur rregullat e VKM-së, që praktikantët të kenë diplomë bachelor”*.

Gjatë seancës dëgjimore përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë i qëndroi të njëjtave parashtrime të bëra të njohura gjatë komunikimit shkresor dhe deklaroi³ se: *“Në këtë proces Ministria e Drejtësisë është institucion mbështetës dhe nuk ka tagra për të vendosur kriteret e tjera përpos zbatimit të VKM 395/2015. Diploma në përfundim të studimeve është dokumenti që presupozon se*

² Referuar deklarimeve të minutës 21.30 e në vijim.

³ Referuar deklarimeve të minutës 41.00 e në vijim.

ke aftësitë e duhura për tu përfshirë në programin e praktikave të punës dhe nuk e di se si mund të realizohet praktika, duke pasur parasysh që orari i punës është nga ora 08.00 deri në 16.30”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A.1 Lidhur me pretendimin e ankuesit për diskriminim nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Ministria e Drejtësisë.

Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar, ka miratuar kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor.

Në pikën 3 të vendimit sipërcituar, parashikohet se: “Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë ‘Bachelor’”, ndërsa në pikën 6, parashikohet se: “Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri përgjegjës për rininë, që përcakton shpalljen për thirrjen e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit”, dhe në pikën 7 parashikohet se: “Administrata shtetërore dhe institucionet e tjera publike që mbështesin këtë program duhet të paraqesin numrin e praktikantëve dhe profilin e tyre. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë program kanë për detyrë të përcaktojnë 1 person kontakti i cili është përgjegjës për:.....”.

Në zbatim të pikës 6 të VKM 395/2015, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët ka miratuar Urdhrin nr. 2, datë 27.05.2022 “Për shpalljen e thirrjes së shtatë në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës”, i cili përcakton metodologjinë e organizimit, afatet dhe procedurat e aplikimit, dokumentacionin, kriteret e përzgjedhjes dhe angazhimit të kandidatëve nga institucionet e administratës shtetërore dhe certifikimit të tyre në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës për vitin 2022. Në pikën 3, germa b) të Urdhrit 2/2022, parashikohen kriteret e aplikimit në të cilën parashikohet se: “Aplikantët duhet të jenë minimalisht të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë “Bachelor”, deri në datë 12.09.2022”.

Në zbatim të pikës 7 të VKM 395/2015, Ministria e Drejtësisë, ka miratuar Urdhrin nr. 268, datë 13.06.2022 “Për ngritjen e Komisionit të përzgjedhjes së praktikantëve në kuadër të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, Thirrja VII”.

Pas shpalljes së thirrjes së shtatë të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës, ankuesi ka aplikuar nëpërmjet plotësimit të të dhënave në faqen e internetit të Programit duke dërguar CV-në dhe një letër motivimi. Me anë të e-mailit datë 25.08.2022, është njoftuar nga Ministria e Drejtësisë se duhet të dërgonte me e-mail dokumentet si vijon: Jetëshkrim; Diplomat; Listë notash; Letër rekomandimi dhe Dokument identifikimi.

Ankuesi me e-mailin datë 25.08.2022, ka informuar Ministrinë e Drejtësisë se: “...kam përfunduar vitin e tretë të studimeve në Fakultetin e Drejtësisë, UT. Diplomën nuk mund ta vendos në dispozicion, pasi me ndryshimet ligjore të vitit 2019, diploma merret pas kryerjes së 5 viteve studime në fakultetin e drejtësisë”.

Në mungesë të dorëzimit të diplomës së përfundimit të studimeve, Komisioni i përzgjedhjes së praktikantëve të Ministrisë së Drejtësisë, ka vendosur moskualifikimin e A.B, pasi rezultonte të ishte në proces studimi.

Ankuesi pretendon se është diskriminuar nga ana e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Ministria e Drejtësisë, pasi këto institucione duhet të kishin marrë masa që të lejonin të kualifikoheshin edhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë që sapo kishin përfunduar vitin e tretë, dhe nuk kishin diplomë të ciklit të parë “Bachelor”.

Bazuar në sa më sipër, si dhe në analizë të veprimeve të kryera nga Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Ministria e Drejtësisë, Komisioneri vlerëson se:

Ministritë, në praktikën e ndjekur lidhur me kriterin e zotërimit të një diplome të ciklit të I-rë “Bachelor”, për aplikantët që do të përfitonin nga parashikimi ligjor i pikës 3, të VKM-së 395/2015, të ndryshuar, kanë zbatuar përcaktimet ligjore të këtij akti, të cilat janë detyruese për ta.

Në këtë kontekst, Ministritë nuk kanë trajtuar në mënyrë diferencuese subjektin ankues, për sa kohë ky diferencim nuk vjen nga mënyra apo procedura e ndjekur për zbatimin e tij, por nga vetë akti, të cilin Ministritë kanë qenë të detyruar ta zbatojnë.

Neni 116 i Kushtetutës, në pikën 1 dhe 3, të tij ka përcaktuar se:

“1. Aktet normative që kanë fuqi juridike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë: a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministria e Drejtësisë kanë zbatuar VKM-në objekt shqyrtimi, i cili është një akt nënligjor i detyrueshëm për institucionet dhe se ankuesi nuk i është nënshtruar një trajtimi diferencues nga ana e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Ministria e Drejtësisë. Në mungesë të një trajtimi të tillë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe nga Ministria e Drejtësisë, për shkaqet e pretenduara nga subjekti ankues, e për rrjedhojë nuk konstatohet se ka shkelje të dispozitave të LMD-së, nga ana e Ministrive.

A.2 Lidhur me pretendimin për diskriminim nga pika 3, e VKM nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar.

Lidhur miratimin e VKM-së nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se institucioni përgjegjës, për nxjerrjen e këtij akti është Këshilli i Ministrave (KM).

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, jemi në kushtet kur trajtimi i padrejtë, i pabarabartë dhe më pak i favorshëm, për kategorinë e studentëve që studiojnë për drejtësi nga viti 2019, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krahasuar me studentët që janë diplomuar me diplomë të ciklit të parë “Bachelor”, prezumohet se ka ardhur pikërisht si rezultat i zbatimit të këtij akti nënligjor.

Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ka miratuar Vendimin nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, i ndryshuar. Në pikën 3 të vendimit, parashikohet se: “Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë ‘Bachelor’”.

Ligji nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 1, germa d) e tij, ka përcaktuar se, arsimi i lartë është e mirë dhe përgjegjësi publike dhe ka për mision, të mbështesë prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të vendit.

Neni 2 i këtij ligji, ka përcaktuar se, qëllimi i tij është:

- a) të përcaktojë rolin e shtetit në arsimin e lartë;
- b) të përcaktojë misionin, objektivat kryesorë të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, rregullat e krijimit, organizimit, drejtimit, administrimit, financimit dhe mbylljes së institucioneve të arsimit të lartë;
- c) të krijojë një sistem të unifikuar të arsimit të lartë, kërkimit shkencor në institucionet e arsimit të lartë, inovacionit bashkëkohor e konkurrues në hapësirën europiane të arsimit të lartë;
- ç) të krijojë mekanizma të qëndrueshëm të sigurimit të cilësisë në institucionet e arsimit të lartë, në përputhje me standardet europiane;
- d) të vendosë arsimin e lartë mbi baza të qëndrueshme financiare, duke krijuar mundësinë për shfrytëzimin e burimeve të ligjshme të financimit;

dh) të garantojë mundësi të barabarta, mbi bazën e meritës, për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në arsimin e lartë;

e) të bazojë sistemin e arsimit të lartë mbi parimin e konkurrencës së lirë mes institucioneve të arsimit të lartë, personelit akademik dhe studentëve”.

Ky ligj në nenin 5, pika 1, të tij, ka sanksionuar rolin e shtetit në arsimin e lartë, duke përcaktuar, se: “1. Shteti ushtron funksione rregullatore dhe krijuese të institucioneve publike të arsimit të lartë, si dhe financon arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”.

Në nenin 6, pika 22 termi “Programi i studimit” përkufizohet si: “Programi i studimit është një tërësi veprimtarish akademike dhe/ose kërkimore shkencore, përfundimi me sukses i të cilave i jep të drejtën studentit të pajiset me një certifikatë, diplomë ose gradë shkencore prej institucionit të arsimit të lartë që e ofron atë, në varësi të llojit të programit të studimit”.

Në nenin 73, pika 2 dhe 3, të këtij ligji parashikohet se: “1. Studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar ose punim diplome..... 3. Në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma “Bachelor” në fushën e arsimimit të kryer”.

Në nenin 75, pika 3/b, të këtij ligji parashikohet se: “3. Programet e studimit “Master i shkencave” pajisin të diplomuarit me njohuri të thelluara teorike, si edhe me aftësim për kërkim shkencor në një fushë të caktuar. Këto programe organizohen në: b) programe të integruara të studimeve të ciklit të dytë, që realizohen me 300 dhe 360 kredite dhe me kohëzgjatje normale respektivisht pesë dhe gjashtë vite akademike. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë ofrohen në fushat e drejtësisë, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës. Këshilli i Ministrave përcakton fusha të tjera, në të cilat mund të ofrohen programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë”.

Gjithashtu, në nenin 82, pika 1 dhe 2, të ligjit 80/2015, përcaktohet se: “1. Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në fushën e drejtësisë realizohen me 300 kredite, për një kohëzgjatje prej jo më pak se 5 vite akademike; 2. Personat që kanë kryer studimet e integruara në drejtësi, ose në një program të ciklit të dytë të studimeve, të barasvlershëm me to, mund të konkurrojnë për t'u përgatitur si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, noterë, avokatë të shtetit, përmbaues privatë ose shtetërorë, si dhe jurist në administratën shtetërore, qendrore dhe vendore, pasi të kenë kryer provimin e shtetit në drejtësi”.

Në zbatim të pikës 1 të nenit 82 të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, për riorganizimin e programeve mësimore në fushën e drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sportit, ka nxjerrë Udhëzimin nr. 10, datë 15.05.2019 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, në të cilin udhëzohen dhe procedurat për regjistrimin e studentëve për vitin akademik 2019-2020, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

Referuar sa më lart, Komisioneri vëren se:

Shqipëria u bë anëtare e kartës së Bolonjës në vitin 2003 dhe universitetet shqiptare nisën të zbatonin programet e ndara në tre cikle studimi, “Bachelor”, “Master” dhe “Doktoraturë”. Me miratimin e ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, u parashikua se programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, do të ofrohen në fushat e drejtësisë⁴, mjekësisë, të stomatologjisë, të farmacisë, të veterinarisë e të arkitekturës dhe dy degët e para që kanë pasur nevojën e riorganizimit dhe shkëputjes prej kartës së Bolonjës, ishin Mjekësia dhe Drejtësia.

Ndërkohë, zbatimi i kurrikulave të reja në Drejtësi (cikli 5-vjeçar) ka nisur në vitin akademik 2019-2020 dhe përfundon në vitin akademik 2023-2024 dhe periudha për dy vitet akademike 2022-2023 dhe 2023-2024, është një periudhë tranzitore në të cilën studentët që ndjekin studimet për drejtësi në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë në të gjithë universitetet publike të vendit, nuk kanë mundësi që të përfitojnë nga programi kombëtar i praktikave të punës.

Referuar deklarimeve⁵ të drejtuesve të disa institucioneve të arsimit të lartë që ofrojnë studime për drejtësi, rezulton se zbatimi i ndryshimit të sistemit të studimeve për drejtësi erdhi si nevojë e reformës në arsim dhe asaj në drejtësi dhe studentët në përfundim të programit të integruar e kanë fushën e punësimit më të gjerë dhe janë kandidatë për të vazhduar shkollën e magjistraturës dhe për t’u bërë gjyqtarë dhe prokurorë. Specialistët e arsimit vlerësojnë se në përfundim të programit mësimor 5-vjeçar studenti zotëron njohuri të thelluara në legjislacionin vendas dhe të huaj dhe përvetëson një qasje ndërdisiplinore mbi lëndët dhe drejtimit e ndryshme të së drejtës, duke qenë i përgatitur të vazhdojë studime të mëtejshme, të thelluara dhe të specializuara në drejtësi.

Referuar Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026⁶, rezulton se në Shqipëri funksionojnë 15 institucione publike të arsimit të lartë, dhe në shumicën e tyre ofrohen studime në fushën e drejtësisë sipas programeve të hartuara nga këto institucione, në kuadër të lirisë akademike. Pra programet dhe planet mësimore planifikohen sipas vetë institucioneve të arsimit të lartë⁷ dhe nuk janë të unifikuara në masën 100%, për të gjitha IALP-të.

Referuar ligjit për arsimin e lartë, studentët në përfundim të programit të ciklit të parë të studimeve u lëshohet diploma “Bachelor” dhe në përfundim të programit të integruar të studimeve të ciklit të dytë u lëshohet diplomë e përfundimit të ciklit të dytë.

⁴ https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Raport_Ministria_Arsimit.pdf. Komisioni për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor, në Raportin e parë për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, Tiranë janar-prill 2014, në pikën 7.6.10 ka sugjeruar: “Të përcaktohen edhe programe të tjera me cikël unik 5 vjeçar veç atyre aktuale, për shembull drejtësi, etj., në përputhje me përvojat më të mira evropiane”.

⁵ <https://abcnews.al/ndryshojne-studimet-ne-drejttesi/>

⁶ Miratuar me VKM nr. 621, datë 22.10.2021.

⁷ Në nenin 35/1 të ligjit 80/2015, parashikohet se: “1. Hapja e programeve të studimit, mbyllja, si dhe riorganizimi i tyre në masën mbi 20 për qind të përmbajtjes së tyre, të shprehur në kredite, pas një cikli të plotë studimi, miratohet nga ministria përgjegjëse për arsimin, në bazë të kërkesës së institucionit të arsimit të lartë, bazuar në vlerësimin e nevojave për aftësi në tregun e punës dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji”.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se diploma e integruar e ciklit të dytë nuk është një bashkim mekanik 3+2, por është program mësimor i shkrirë në 5 vite, sipas planit mësimor të institucionit të arsimit të lartë.

Duke pasur parasysh vështirësitë praktike që mund të shfaqen në interpretimin e vlerësimit të njohurive në përfundim të studimeve të vitit të tretë, duke ditur se janë shumë IALP që ofrojnë studime në degën e drejtësisë dhe që të gjithë kanë liri akademike në organizimin e programit të studimit, Komisioneri vlerëson se institucionet e administratës shtetërore dhe institucioneve të tjera publike që do të duhet të përzgjidhnin aplikantët për praktikën e punës, e kanë shumë të vështirë që të marrin përsipër të certifikojnë arritjet e aplikantëve në përfundim të vitit të tretë të studimeve. Ligji 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe Kërkimin shkencor” në nenin 70/2 dhe 73/1 ka parashikuar se sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik nga një student është 60 kredite dhe programi i ciklit të parë të studimit, organizohet me jo më pak se 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike, pra duhet pasur parasysh që vitet akademike nuk janë thjeshtë vitet matëse të arsimit të një studenti, por janë kreditet ato që përcaktojnë vitin akademik. Pra, fakti që një student ndodhet në vitin e tretë të studimit nuk është ndonjë indikator i matshëm apo tregues objektiv dhe i saktë mbi ndonjë status të veçantë të një studenti.

Nga ana tjetër, Komisioneri vëren se impianti rregullator i Arsimit të Lartë midis ligjit, akteve nënligjore dhe akteve rregullatore të vetë IAL-ve, në bazë të parimit të lirisë dhe autonomisë së IALP-ve, mund të gjenerojë situata të ndryshme e për rrjedhojë jo të barabarta midis tyre. Kjo, jo domosdoshmërisht krijon premisa për diskriminim kundrejt brezave të ndryshëm të studentëve, pasi dhe efekti i ndryshimit të programit të studimit për drejtësi është tranzitor, për një periudhë dy vjeçare.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se vendosja e kriterit që aplikanti duhet të jetë minimalisht i diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë, për të aplikuar për të përfutur nga programi i praktikave të punës, është objektiv.

Vendimi i Këshillit të Ministrave, objekt shqyrtimi jo më kot ka vendosur kriterin e pasjes së një diplome, për të përfutur nga programi kombëtar i praktikave të punës, pasi ai është një kriter objektiv dhe i matshëm dhe fakti i pasjes së një diplome, unifikon të gjithë aplikantët duke mos lënë hapësirë për vlerësim subjektiv apo interpretim nga institucione të ndryshme. Rasti i subjektit ankues është që nuk ka përfunduar një cikël studimi dhe nuk është i pajisur me diplomë, prandaj në kushtet e VKM-së 395/2015, të ndryshuar, nuk mund të përfutojë nga programi kombëtar i praktikave të punës.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 7, parashikon se: *“Diskriminimi i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter ose praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte më pak të favorshme, për shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, kur ajo dispozitë, kriter a praktikë nuk justifikohet objektivisht nga një synim i*

ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”.

Në përfundim Komisioneri, vlerëson se nuk konstatohet se ka shkelje të nenit 3, pika 7, të ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar dhe për rrjedhojë parashikimi i pikës 3 të VKM-së nr. 395, datë 29.04.2015 “Për miratimin e programit kombëtar të praktikave të punës në administratën shtetërore dhe institucionet e tjera publike”, të ndryshuar, nuk është diskriminues.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/7, nenin 7/1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të A.B nga ana e Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Ministrisë së Drejtësisë për shkak të gjendjes arsimore dhe çdo shkak tjetër.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA